



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**

UDHËRRËFYESI PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN

DY SKENARË PËR KOSOVËN



Prishtinë, Kosovë

Tetor 2020

UDHËRRËFYESI PËR
ANËTARËSIM NË
BASHKIMIN EVROPIAN

DY SKENARË PËR KOSOVËN

E drejta e autorit © 2020. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Përgaditi:

Demush Shasha

Dizajnoi:

Ngadhujim Halilaj

Ky dokument prodhohet nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), si pjesë e projektit "Rruga Dytësore Drejt Evropianizimit: Një Qasje Partneriteti", i mbështetur nga Fondacionet për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet në lidhje me këtë dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionet për Shoqëri të Hapur.

Hyrje


Kosova është në fillet e procesit integruar në Bashkimin Evropian. Në prill 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e cila është marrëveshja e parë kontraktuale mes Kosovës dhe BE-së dhe përbën hapin e parë zyrtar drejt anëtarësimit në BE. Prosesi i anëtarësimit në BE është një proces shumë kompleks dhe sfidues. Reformat evropiane kërkojnë vullnet të palëkundur politik, burime të mjaftueshme financiare, administratë profesionale publike dhe përkrahje të gjerë diplomatike brenda BE-së. Prandaj, me këtë udhërrëfyes, kemi tentuar të shpjegojmë çdo hap të procesit integruar dhe informatave kyçe për anëtarësim në BE.

Në kuadër të udhërrëfyesit për anëtarësim në BE, kemi tentuar të paraqesim dy skenarë të mundshëm të afateve kohore të Kosovës për anëtarësim në BE, skenarin optimist dhe pesimist. Në afatin optimist, Kosova mund bëhet vend anëtar i BE-së deri në vitin 2030. Kjo do ishte tejet ambicioze, por në përputhje me përvojën integruar të Kroacisë. Një gjë e tillë do kërkonte vullnet të palëkundur për reformat në sundimin e ligjit, progres në dialogun me Serbinë dhe bashkëpunim të plotë me Gjykatën Speciale. Gjasat që Kosova të jetësoj këtë skenar janë jashtëzakonisht të vogla. Ndërsa, në afatin pesimist, Kosova mund bëhet vend anëtar i BE-së deri në vitin 2050. Kjo do ishte në përputhje me përvojën integruar të Shqipërisë dhe vendeve që ende janë në procesin negociator (Mali Zi dhe Serbia).

Sidoqoftë, përtej afateve, çdo gjë do varet nga Kosova dhe në këtë drejtim përvoja nuk është në favorin tonë. Katër vite kanë kaluar nga hyrja në fuqi e MSA-së. Kosova nuk ka arritur të zbatoj me sukses obligimet që dalin nga MSA. Me këtë trend të vullnetit politik, skenari pesimist është pothuajse i garantuar. Po ashtu, duhet njohur disa faktorë të jashtëm – brenda BE-së mungon apetiti për përshpejtimin e procesit të zgjerimit. Kosova ende nuk njihet nga pesë vendet anëtare të BE-së. Përderisa deri me sot, institucionet e BE-së kanë gjetur një zgjidhje praktike ligjore për të evituar veton e pesë vendeve anëtarë, hapat e ardhshëm në rrugën tonë integruar do të kërkojnë njohjen nga pesë vendet anëtare të BE-së. I gjithë ky kontekst politik do të ndikoj në rrugëtimin Evropian të Kosovës. Nuk mund ta dijmë se cila do jetë e ardhmja, prandaj vetëm shpresojmë se me këtë publikim do ofrojmë disa informata të reja të cilat do na ndihmojnë për tu përgatitur sa më mirë për të ardhmen që na pret.

Udhërrëfytyesi për anëtarësim në BE

Dy skenarë kohorë për anëtarësim në BE



1. Kërkesa për Anëtarësim në BE

Në përputhje me nenin 49 të Traktatit të BE, Kryeministri i Kosovës dorëzon kërkesën për anëtarësim në BE pranë Presidencës së radhës të Këshillit të BE-së. Kërkesa e merr formën e një letre zyrtare. Letra duhet të shprehë përkushtimin e Kosovës për respektimin dhe promovimin e vlerave mbi të cilat është i themeluar Bashkimi Evropian dhe ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshëm për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE.

Para dorëzimit formal të kërkesës, institucionet duhet të sigurohen se ekziston vullneti i nevojshëm politik brenda BE-së për të shqyrtuar dhe për të miratuar kërkesën. Kjo pasi që në një skenar pesimist, mund të ndodh që Këshilli të mos e shqyrtoj fare kërkesën e dorëzuar.

Në skenarin optimist, pas dorëzimit të kërkesës, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së (*General Affairs Council – GAC*), do të shqyrtoj kërkesën dhe do të dërgoj atë tek Komisioni Evropian. Këshilli do të kërkon nga Komisioni Evropian që të përgatis një opinion (*avis*) mbi meritat e aplikimit të vendit aspirues.

Në skenarin optimist, Kosova do të mund të dorëzojë kërkesën për anëtarësim në BE gjatë vitit 2021. Një skenar i tillë do të kërkonte progres të ndjeshëm në sundim të ligjit, dialogun me Serbinë, evitimin e bllokimit nga ana e pesë vendeve mosnjohëse të BE-së dhe bashkëpunimin me Gjykatën Speciale.

Në skenarin pesimist, Kosova nuk do të bëjë progres të ndjeshëm në asnjë nga fushat e cekura dhe rrjedhimisht kërkesa nuk do mund të dorëzohet deri në vitin 2022.

2. Rekomandimi për Statusin Kandidat (avis)

Këshilli i BE-së është institucion i BE-së i cili ka mandat për të aprovuar kërkesën për anëtarësim në BE dhe rrjedhimisht t'i ofroj Statusin e Vendit Kandidat Republikës së Kosovës. Vendimi i Këshillit të BE-së bazohet në opinionin e Komisionit Evropian. Opinioni apo "avis" është një raport analitik që bënë vlerësimin e përmbushjes së Kriterëve të Kopenhagës, përgjatë 33 kapitujve të *acquis communautaire* të BE-së.

Me qëllim të përgatitjes së opinionit, Komisioni Evropian fillon përgatitjen e Pyetësorit për Kosovën. Pyetëtori është një instrument formal përmes të cilit Komisioni vlerëson gatishmërinë e vendit aspirues për të avancuar në procesin e anëtarësimit, përkatësisht për t'u dhënë statusin e vendit kandidat. Pyetëtori i fundit në rastin e Bosnjës ka pasur 3,242 pyetje. Komisioni do i jap Kosovës një afat kohor për t'u përgjigjur në Pyetësor.

Kosova duhet të dorëzoj formalisht përgjigjet në Pyetësorin pranë Komisionit Evropian, ndërsa Komisioni ruan të drejtën për pyetjet shtesë në varësi prej përgjigjeve të pranuar. Njëkohësisht, Komisioni do bëjë konsultime të nevojshme me institucionet e ndryshme ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile. Pas pranimit të përgjigjeve, Komisioni e paraqet Opininion e tij pranë Këshillit të BE-së për një vendim politik sa i përket kërkesës për anëtarësim të Kosovës.

Në skenarin optimist, Kosova do të mund të finalizoj përgjigjet në pyetësorin gjatë vitit 2021, gjë që do të kishte hapur rrugë për të pranuar rekomandimin për statusin e vendit kandidat në vitin 2022. Një dinamikë e tillë kohore do ishte në përputhje me përvojën integruese të Kroacisë. Natyrisht, një skenar i tillë do të kërkonte përkrahje të gjerë diplomatike nga 27 vende anëtarë të BE-së.

Ndërsa në skenarin pesimist, rrugëtimi i Kosovës do karakterizohet me vështirësi të shumta. Shkaku kryesor do të jetë mungesa e vullnetit politik për të marr përsipër obligimet që burojnë nga procesi integruar. Sundimi i ligjit do vazhdoj të jetë i dobët. Dialogu me Serbinë nuk do shënoj progres. Reformat kuptimplota sikur reforma zgjedhore dhe reforma e administratës publike do vazhdojnë të ngecin. I gjithë ky mjedis politik do të ngadalësoj rrugëtimin integruar të Kosovës. Rrjedhimisht do jetë e pamundur që Kosova të pranoj rekomandimin për statusin e vendit kandidat deri në vitin 2025. Një dinamikë e tillë kohore do ishte në përputhje me përvojën integruese të Shqipërisë.

3. Statusi Kandidat

Në opinionin e tij Komisioni Evropian do e jap mendimin e vet nëse Kosovës duhet ofruar statusin e vendit kandidat apo Kosova duhet të plotësoj kriteret shtesë para marrjes së statusit të vendit kandidat. Fjalën përfundimtare e ka trupi vendimmarrës apo Këshilli Evropian, i asistuar nga Këshilli i BE-së për Çështje të Përgjithshme. Këshilli Evropian duhet marr vendimin për dhënien e statusit të vendit kandidat me unanimitet.

Në skenarin optimist, nëse vendet anëtare janë të kënaqura me progresin e arritur nga Kosova dhe opinionin e Komisionit Evropian, atëherë Kosova do të mund të pranoj statusin e vendit kandidat brenda disa muajve pas rekomandimit të Komisionit Evropian. Kjo do të ishte në përputhje me përvojën e procesit integruar të Kroacisë.

Në skenarin pesimist, Komisioni Evropian nuk do rekomandoj dhënien e statusit të vendit kandidat, por do të përcaktoj kriteret shtesë që Kosova duhet të përmbush para marrjes së statusit të vendit kandidat. Po ashtu, ngeçjet e vazhdueshme të Kosovës në avancimin e reformave Evropiane do të shkaktojnë pakënaqësi të vazhdueshme në mesin e vendeve anëtare të BE-së. E gjithë kjo do ndikoj që Kosova të mos arrij të fitoj statusin e vendit kandidat deri në vitin 2027. Një dinamikë e tillë kohore do ishte në përputhje me përvojën integruar të Shqipërisë.

4. Nisja e Negociatave

Pas vendimit të Këshillit Evropian për t'i dhënë Kosovës statusin e vendit kandidat, Kosova do synoj hapin e ardhshëm, respektivisht nisjen e negociatave të anëtarësimit. Pas nivelit të kënaqshëm të zbatimit të obligimeve që burojnë nga MSA dhe instrumentet e tjera të këtij procesi, KE-ja do rekomandoj nisjen e negociatave të anëtarësimit për Kosovën.

Këshilli Evropian, i asistuar nga Këshilli për Çështje të Përgjithshme, do merr vendimin për nisjen e negociatave me unanimitet. Negociatat për anëtarësim zhvillohen midis ministrave dhe ambasadorëve të qeverive të BE-së dhe Kosovës me anë të Konferencave Ndërqeveritare. Subjekt i negociatave janë kushtet dhe afatet kohore të transpozimit dhe zbatimit të gjithë legjislacionit të BE-së (acquis). Acquis është i ndarë në 33 kapituj, plus kapitulli 34 që mbulon aranzhimet institucionale dhe kapitulli 35 për çdo çështje tjetër që nuk mbulohet brenda 34 kapitujve.

Negociatat teknike zhvillohen në kuadër 35 kapitujve të grupuara në gjashtë grupe tematike: [1] Fundamentet; [2] Tregu i brendshëm; [3] Konkurrueshmëria dhe zhvillimi i brendshëm; [4] Agjenda e gjelbër dhe interkonektiviteti; [5] Resurset, agrikultura dhe kohezioni; [6] Marëdhëniet me jashtë.

Grupi i kapitujve i cili ka të bëjë me sundimin e ligjit apo “fundamentals” hapet për negociatat i pari dhe mbyllet i fundit. Shpejtësia e negociatave varet nga shpejtësia e reformave dhe përafrimit të ligjeve nacionale. Negociatat për asnjë kapitull nuk konsiderohen të mbyllura derisa çdo qeveri e BE-së të jetë e kënaqur me përparimin e vendit kandidat në atë kapitull, sipas vlerësimit të KE-së. I gjithë procesi negociator konsiderohet i përfunduar vetëm kur negociatat për çdo kapitull janë të mbyllura. Gjatë tërë procesit negociator, Komisioni mban të informuar Këshillin e BE-së dhe Parlamentin Evropian.

Në skenarin optimist, në bazë të përvojës së procesit integruar të Kroacisë, Kosova do mund të filloj negociatat e anëtarësimit në vitin 2023, apo disa muaj pas marrjes së statusit të vendit kandidat. Në skenarin pesimist, në bazë të përvojës së procesit integruar të Shqipërisë, Kosova nuk do filloj negociatat e anëtarësimit deri në vitin 2033.

5. Përfundimi i negociatave

Pas përfundimit të negociatave për secilin kapitull negociator, Komisioni Evropian përgatit një raport të veçantë i cili jap vlerësimin për gatishmërinë e vendit kandidat për të marr përsipër obligimet që burojnë nga anëtarësimi në BE. Njëkohësisht, raporti propozon përmbylljen e negociatave të anëtarësimit.

Më tutje raporti shqyrtohet nga Këshilli i BE-së i cili aprovon mbylljen formale të negociatave dhe e cila duhet të zyrtarizohet në kuadër të Konferencës Përfundimtare Ndërqeveritare. Po ashtu, Këshilli propozon nënshkrimin e Traktatit të Anëtarësimit, si dhe datën e anëtarësimit.

Dakordimi në nivel Këshillit të BE-së merr formën finale në kuadër të konkluzioneve të samitit të Këshillit Evropian apo shefave të shtetit/qeverive të vendeve anëtare të BE-së. Deri në momentin e konfirmimit të përmbylljes së negociatave nga ana e Këshillit Evropian për të gjithë kapituj negociatorë, ekziston mundësia e ri-hapjes së negociatave për secilin kapitull negociator – në rast të mungesës së progresit të mjaftueshëm nga ana e vendit kandidat.

Rezultatet e negociatave të anëtarësimit formalizohen brenda Traktatit të Anëtarësimit dhe Aktit të Anëtarësimit. Këto dokumente rregullojnë të gjitha detaje dhe kushtëzime për anëtarësimin e vendit kandidat, siç janë: data e anëtarësimit, rezultatet e negociatave, periudhat tranzitore, aranzhimet financiare, aranzhimet institucionale, etj).

Traktati i Anëtarësimit është marrëveshje bilaterale ndërkombëtare ndërmjet vendeve anëtare të BE-së dhe vendit kandidat. Pas nënshkrimit, traktati fillon procesin e ratifikimit brenda vendeve anëtare të BE-së dhe po ashtu duhet të aprovohet nga ana e Parlamentit Evropian.

Deri në hyrjen në fuqi të Traktatit të Anëtarësimi, vendi kandidat merr pjesë në punimet e institucioneve të BE-së në cilësinë e vëzhguesit. Në këtë formë, vendit kandidat i mundësohet të monitoroj nga afër procesin e miratimit të vendimeve të BE-së. Po ashtu, pritjet nga vendi kandidat që të vazhdoj me rigorozitet përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së.

Në skenarin optimist, në bazë të përvojës së procesit integruar të Kroacisë, Kosova do mund të përfundoj negociatat e anëtarësimit në vitin 2029, apo 6 vite pas nisjes së tyre. Në skenarin pesimist, në bazë të përvojës së procesit integruar të Malit të Zi, Kosova nuk do arrij të përfundoj negociatat e anëtarësimit deri në vitin 2048.

6. Ratifikimi i Traktatit të Anëtarësimit

Traktati i anëtarësimit duhet të nënshkruhet nga të gjitha vendet anëtare dhe Kosova, ai miratohet me unanimitet nga Këshilli Evropian, ndërsa Parlamenti Evropian duhet të jap pëlqimin e tij. Traktati ratifikohet nga Kosova dhe çdo vend anëtar i BE-së, sipas rregullave respektive kushtetuese.

Secili vend anëtar i BE-së pas ratifikimit të Traktatit të Anëtarësimit duhet të deponoj Instrumentin e Ratifikimit pranë Qeverisë së Republikës së Italisë.

Pas përfundimit të procesit ratifikues të Traktatit të Anëtarësimit nga të gjitha vendet anëtare të BE-së dhe vendit kandidat, traktati hynë në fuqi sipas datës së përcaktuar brenda traktatit.

7. Vend Anëtar i BE-së

Ceremonia festive e aderimit të Kosovës në BE. Kosova merr përsipër të gjitha të drejtat dhe obligimet që burojnë nga të qenurit vend anëtar i BE-së.

Kosova organizon zgjedhjet për deputetë të Kosovës e Parlamentit Evropian. Institucionet e Kosovës emërojnë përfaqësues të tyre brenda institucioneve dhe trupave të BE-së. Kosova fillon të përfitoj nga fondet e BE-së të rezervuara për vendet anëtare të BE-së. Qytetarët e Kosovës fillojnë të gëzojnë të drejtat e barabarta sikur qytetarët e BE-së.

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup analistësh të cilët shqetësoheshin gjithnjë e më shumë se ushtrimi i shtet-ndërtimit kishte neglizhuar demokracinë.

Vizioni i D4D është promovimi i një qytetarie aktive dhe të arsimuar që merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe shfrytëzon arenën publike të përfaqësimit dhe vendimmarrjes për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus mbi ndarjen e burimeve që janë efikase, të zgjuara, afatgjata dhe që sjellin për zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politika specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale në zgjidhjen e problemeve, dhe adreson rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime graduale dhe vepron me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin dhe zhvillimin demokratik të Kosovës.

Për më shumë informacion në lidhje me aktivitetet e D4D, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: **www.d4d-ks.org**.